



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit
P- 101
Prishtinë, më 4 mars 2010

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 4 MARS 2010**

Seancën e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetari i Kuvendit, ndërsa i ndihmoi **Xhavit Haliti**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 87 deputetë.

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, së bashku me kryetarët e grupeve parlamentare, në mbledhjen e mbajtur më 23 shkurt 2010, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Kuvendi në vazhdim i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e:

- 1. Debat sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të LDD-së për zbatimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe për praninë e strukturave të pushtetit të Serbisë në territorin e Republikës së Kosovës**

Kryetari tha se çështja për të cilën po debatojmë sot ka rëndësi të madhe, sepse duhet ta ndërtojmë një qëndrim unik për të ofruar një zgjidhje të qëndrueshme për të gjithë qytetarët në atë pjesë të Kosovës. Si institucione do të ofrojmë ofertën tonë për problemet e krijuara, e cila bazohet në mjete paqësore dhe në pajtim me partnerët tanë ndërkombëtarë.

Kryetari i Kuvendit ftoi kryetarin e LDD-së që në emër të propozuesit të kërkesës për debat, të paraqesë arsyetimin e tij.

Nexhat Daci, në fillim tha se beson që deputetët e Kuvendit pajtohen se Kosova është në atë pozicion që kërkon debat për gjendjen e krijuar në pjesën veriore të vendit. Kuvendi gjatë dhjetë viteve vetëm dy herë ka debatuar për gjendjen në Kosovë, në kohën kur Kuvendi nxori Rezolutën për mbrojtjen e kufijve të Kosovës, si dhe në vitin 2005, kur Kuvendi gjeti forcë për krijimin e unitetit absolut për bisedimet rreth statusit të Kosovës, që u mbajtën në Vjenë.

Si LDD vlerësojmë se tani është momenti që përfaqësuesit e popullit të krijojnë një unitet për gjendjen në veriun e Kosovës. Kosova po zvogëlohet nga dy aspekte, nga aspekti territorial, ku në veri të Kosovës, shteti fqinj – Serbia po ushtron pushtetin e vet me të gjithë dikasteret shtetërore, kurse aspekti i dytë është ai i ikjes së të rinjve nga Kosova. Në këtë kontekst ai përmendi edhe tragjedinë në lumin Tisa, të ndodhur kohë më parë, gjatë tentimit të shqiptarëve për kalim në Evropën Perëndimorë, si dhe aksidentin fatal të autobusit nga Kosova në afërsi të Vjenës, por edhe faktorët tjerë si: varfërinë, krimin e organizuar etj.

Ai në vazhdim potencoi disa të dhëna, si rritjen e papunësisë, rritjen e varfërisë, mbylljen, siç tha, të 1000 ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Kosovë, për të cilat tema Kuvendi nuk ka debatuar asnjëherë. Ai përmendi më pas edhe mungesën e mbikëqyrjes së duhur të Qeverisë nga ana e Kuvendit.

Në fund, theksoi se është mendim i LDD-së se debati ka për qëllim dhënien e përgjigjeve për këto çështje, kurse në fund të debatit Kuvendi duhet për këtë pikë të nxjerrë një rezolutë.

Kryetari ftoi më pas Kryeministrin e Republikës së Kosovës për fjalë.

Hashim Thaçi, në fillim tha se sot para deputetëve do të paraqes Strategjinë për integrimin e veriut Kosovës, e cila është bazë për përpjekjet tona unike për integrimin e veriut. Ai tha se dy vjet pas pavarësisë së Kosovës, vendi po përballlet me këtë çështje, si dhe me sfidat tjera, siç janë zhvillimi ekonomik, integrimi në strukturat e BE-së, por edhe funksionimi i shtetit të Kosovës në tërë territorin e tij.

Më tej përmendi si lajm të mirë, i cili është në funksion të integritetit të kësaj pjese, faktin e mbajtjes së suksesshme të zgjedhjeve lokale në Kosovë, ku qytetarët serbë zgjedhën liderët e tyre legjitim për komunat e reja, si dhe në Shtërpçë, të cilët kanë përkrahjen e plotë të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Duke folur për Strategjinë e Qeverisë, ai potencoi se zbatimi i saj nuk nënkupton përdorimin e forcës, por kjo nuk do të thotë se shpërdoruesit edhe në atë pjesë nuk do të ballafaqohen me ligjin. Kurse në lidhje me reformimin e pushtetit lokal – decentralizimin, në atë pjesë të Kosovës, kryeministri tha se ai do të vazhdojë me krijimin e komunës së Mitrovicës së veriut, në të cilën do të ketë zyrë lokale për komunitetet e tjera.

Në kontekst të investimeve që janë bërë në atë pjesë të Kosovës nga ana e Qeverisë për dy vitet 2008-2009, tha se janë investuar tetë milion euro, kurse të gjithë atyre që

dëshirojnë të kthehen në pronat e veta u garantoj përkrahjen e Qeverisë dhe të institucioneve të Republikës së Kosovës.

Kryeministri tha se Qeveria së fundi ka emëruar një koordinator për pjesën veriore dhe së shpejti pritet të fillojnë punën grupet e përbashkëta punuese në funksion të zbatimit të kushtetutshmërisë në atë pjesë.

Në fund, ai kërkoi nga deputetët mbështetjen për Strategjinë për pjesën veriore të Kosovës, si një dokument i përbashkët i Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe i mekanizmave ndërkombëtarë në Kosovë.

Kryesuesi hapi debatin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Ramë Buja, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se debati i sotëm është i mirëseardhur për të intensifikuar përpjekjet për një zbatim më të mirë të Kushtetutës në tërë vendin, edhe pse në asnjë vend të botës kushtetutat e shteteve nuk mund të zbatohen 100 %. Institucionet e Republikës së Kosovës i obligon Kushtetuta e Kosovës, kurse ne si shtet duhet të jemi më këmbëngulës që të mos lejojmë shtigje të hapura sepse ato shtigje i plotëson tjetërkush, kurse aftësitë e shtetit serb për të plotësuar ato shtigje karshi Kosovës i kemi të njohur të gjithë, tha ai.

Si grup parlamentar rekomandojmë që në fund të debatit Kuvendi të miratojë një deklaratë lidhur me këtë çështje, konstatoi ai.

Lutfi Haziri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, tha se e mirëkuptojmë Qeverinë që brenda këtij debati t'i parashtojë angazhimet e saja për strategjinë për veriun, por ajo nuk është pjesë e debatit të sotëm.

Ai tha se i refuzojmë zërat e aty-këtushëm për bisedime shitesë për çështjen e statusit, pastaj në Kosovë nuk mund të ketë dy sisteme juridike, as dy zinxhirë komandues në polici. Ai në fund u angazhua që Kuvendi të kërkojë nga Qeveria zbatimin e Pakos së Ahtisarit. Si grup parlamentar përkrahim idenë e nxjerrjes së një deklarate pas këtij debati, tha ai.

Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se grupi parlamentar që ai drejton e mbështet strategjinë e Qeverisë. Në vazhdim, ai tha se si AAK- vetëm dy-tre muaj pas pavarësimit të vendit, asokohe jemi angazhuar që të kemi një plan për veriun e Kosovës dhe tash mu për këtë arsye e mbështesin një gjë të tillë. Por, ajo që është dashur të bëhej, është e dhëna se deputetët e Kuvendit ende nuk e kanë marrë këtë strategji, përderisa ajo është bërë publike kohë më parë, tha ai. Ai më tej pati vërejtje në anën përmbajtësore të strategjisë, por edhe të disa temave të tjera që lidhen me privatizimin dhe ndërtimin e autostradës për të cilat tha se është dashur të debatohet në Kuvend.

Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, shfaqti brengosje për faktin se, siç tha ai, edhe dy vjet pas pavarësimit të Kosovës, afër 20 % e territorit të saj iu është lënë strukturave të shtetit të Serbisë në atë pjesë. Qeveria është treguar e paafte, tha ai, për menaxhimin e këtyre situatave. Më tej tha se Qeveria aktuale nuk e ka krijuar këtë situatë në atë pjesë të vendit, por ajo ka mundur të jetë më aktive në mënyrë që gjendja atje të mos përkeqësohej më shumë.

Xhezair Murati, në emër të Grupit Parlamentar '7+' tha se është për t'u përkrahur iniciativa e Grupit Parlamentar të LDD-së për këtë debat, ashtu siç duhet përkrahur edhe

angazhimet që po i bën Qeveria dhe bashkësia ndërkombëtare në këtë drejtim. Më tej tha se do të kishte qenë më mirë që një debat i tillë të diskutohej para disa viteve. Ai tha se përkrah mendimin që në fund të këtij debati të miratohet një deklaratë e përbashkët.

Slobodan Petroviq, në emër të Grupit Parlamentar SLS tha se edhe pse kjo çështje sado që është e ndjeshme, ne si njerëz përgjegjës duhet të ballafaqohemi me këto çështje. Në vazhdim tha se sa i përket SLS-së, kemi dëshmuar deri më tani se si duhej zgjidhur ky problem. Ai më tej tha se për krijimin e rezultateve të mira në ofertën tonë për popullatën në atë pjesë të Kosovës, kontribut të çmuar kanë dhënë të gjitha institucionet e Kosovës, e në veçanti Qeveria e Kosovës, pozita dhe opozita, si dhe bashkësia ndërkombëtare.

Numan Baliq, në emër të Grupit Parlamentar për Integrim tha se çështja për të cilën po diskutojmë sot është problem që na ka shoqëruar që 10 vjet. Në vazhdim tha se këtë problematikë e kemi identifikuar bashkë me grupin drejtues ndërkombëtar për Kosovën, prej nga janë marrë disa qëndrime shumë të rëndësishme, të cilat duhet t'i kemi parasysh gjatë debatit të sotëm.

Kryetari propozoi formimin e një grupi punues nga kryetarët e grupeve parlamentare, që në fund të këtij debati Kuvendi të nxjerrë një deklaratë për këtë pikë të rendit të ditës. Kuvendi u pajtua me propozimin e kryetarit.

Opinionet, vërejtjet dhe sugjerimet lidhur me këtë pikë të rendit të ditës dhanë këta deputetë: Sabri Hamiti, Besa Gaxheri, Fatmir Limaj, kryeministri Hashim Thaçi, Naim Rustemi, Sanije Aliaj, Ibrahim Gashi, Vezira Emrush, Lulzim Zeneli, Kaqusha Jashari, Branislav Grbiç, Emrush Xhemajli, Ali Lajçi, Suzana Novoberdaliu, Teuta Hadri, Driton Tali, Bujar Dugoolli, Gani Geci, Rustem Mustafa, Ibrahim Selmanaj, Armend Zemaj, Hajredin Kuçi, Mark Krasniqi, Bajram Kosumi, Qamile Morina, Zef Morina, Adem Salihaj, Ahmet Isufi, Jakup Krasniqi, Shkumbin Demaliaj, Arsim Bajrami, Ramë Buja, Rita Hajzeraj, Danush Ademi, Hydajet Hyseni, Naim Maloku, Hashim Thaçi, Njomza Emini, Adem Grabovci, Edita Tahiri, Haset Cakolli, Berat Luzha dhe Hajdin Abazi, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Lulzim Zeneli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, e lexoi një propozim-rezolutë, për të cilën tha se është mirë që Kuvendi ta miratojë sot.

Në emër të kryetarëve të Grupeve Parlamentare deklaratën e lexoi **Ramë Buja**. Ai tha se rreth kësaj deklarate mendimin e ka ndarë kryetari i Grupit Parlamentar të LDD-së.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e deklaratës. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----52,
Kundër-----2,
Abstenime-----4.

Kryetari konstatoi se Kuvendi miratoi deklaratën e paraqitur nga kryetarët e grupeve parlamentare, teksti i plotë i së cilës është:

Kuvendi i Republikës së Kosovës, duke theksuar rolin e vet në zbatimin e plotë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sundimin e shtetit ligjor, luftimin e kriminalitetit dhe të kontrabandës, garantimin e pronës, të lirisë së lëvizjes, të paqes, të demokracisë dhe të perspektivës së zhvillimit ekonomik për mbarë popullin e Republikës së Kosovës, në seancën e mbajtur më 4 mars 2010, pas debatit parlamentar miratoi këtë:

D E K L A R A T Ë

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës rikonfirmon domosdoshmërinë e respektimit dhe të zbatimit të plotë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në tërë territorin e Kosovës, duke garantuar ruajtjen e tërësisë territoriale dhe pacenueshmërinë e kufijve të pranuar ndërkombëtarisht të Republikës së Kosovës.
2. Kuvendi i Republikës së Kosovës mirëpret Deklaratën e Grupit Ndërkombëtar Drejtues për Kosovën, të datës 8 shkurt 2010, në të cilën shprehet mbështetja e plotë për domosdoshmërinë e forcimit të përpjekjeve të institucioneve të Republikës së Kosovës për veriun e Kosovës.
3. Kuvendi i Republikës së Kosovës shpreh përkushtimin e tij për të siguruar që të gjithë shtetasit e Kosovës të gëzojnë mbrojtjen e shtetit ligjor. Kuvendi mirëpret përkrahjen e Bashkimit Evropian e të bashkësisë ndërkombëtare për të bërë të mundur që të gjithë qytetarët të kenë përfaqësim demokratik në pushtetin qendror dhe lokal, të përfitojnë nga shërbimet e investimet dhe të kenë qasje në drejtësi.
4. Kuvendi i Republikës së Kosovës, rritetson përkushtimin e tij ndaj vetëqeverisjes lokale dhe decentralizimit, sipas Propozimit gjithëpërfshirës për statusin e Kosovës, Kushtetutës dhe legjislacionit të miratuar prej tij.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën plenare në orën 17:36 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale